



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
JURIA

Prot 372

Tiranë, më 02.05.2023

Vendim nr. 24 datë 02.05.2023

Për dhënien e mirënjohjes Nderi i Akademisë shkrimtarit dhe studiuesit Jakov Xoxa (pas vdekjes)

Referuar nenit 10 të Rregullores për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre;

Në mbështetje të Vendimit të Kryesisë nr. 19 datë 24.05.2022 Për mirënjohjen "Nderi i Akademisë" dhe për kriteret e procedurat e dhënies së saj;

Me propozim të komisionit të gjuhësisë dhe letërsisë (bashkëngjitur);

Pasi konstatoi plotësimin e kriterëve dhe zbatimin e procedurave sipas parashikimeve si më sipër;

Juria, në mbledhjen e saj të datës __.__.2023,

Vendosi:

1. T'i jepet mirënjohja Nderi i Akademisë shkrimtarit dhe studiuesit Jakov Xoxa (pas vdekjes) me motivacionin:

Për vendin qendror që ka zënë në historinë e romanit shqiptar; të cilin e zhvilloi dhe e modernizoi si gjini e madhe letrare; e pasuroi me karaktere shenjuese nga gjithë hapësira historike kombëtare; mjeshtër i rrëfimit dhe i

ndërthurjes së ligjërimeve; që lartësoi në nivelin e shqipes së gjithëmbarshme të folme lokale të rëndësishme për pasurinë e saj; bashkëthemelues i Universitetit të Tiranës dhe profesor për dy dekada; studiues i teorisë dhe stilistikës letrare; hartues i teksteve shkollore dhe universitare të formimit bazë, që u shërbyen disa brezave studentësh e pedagogësh në Shqipëri e në Kosovë.

3. Mirënjohja Nderi i Akademisë të jepet përmes një ceremonie publike të organizuar sipas përshkrimit në Rregulloren për ceremonialin dhe solemnitetet, në kuadër në veprimtarinë jubilarë kushtuar 100-vjetorit të lindjes së shkrimtarit dhe studiuesit Jakov Xoxa, më 7 qershor 2023.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetari i SSHSHA dhe kancelari.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

